KOMUNIKATË PËR MEDIA
Java e Gruas 2013, Kosovë

PRISHTINË, 25 Mars 2013

Dita e parë e Javës se Gruas, filloi sot duke mbledhur mbi 200 gra dhe mysafirë të ndryshëm, duke filluar javën me një performancë artistike nga Kori i Grave "Lira".
Teuta Sahatqija, Kryetare e Grupit të Grave Deputete, në hapje të programit theksoj se tanimë Java e Gruas po shëndërrohet një ngjarje e rregulltë në Kosovë, një hapësirë e rezervuar për gratë që dëshirojnë të përkrahin gratë tjera, posaçërisht në këtë vitë të zgjedhjeve lokale në Kosovë.

Alexander Chavarria, Drejtor i NDI në Kosovë potencojë, se është përkushtim i NDI në tërë botën, të përkrahë gratë lidere që të kenë ndikim efektiv në të gjitha aspektet e proceseve politike. "Përmes mentorimit, mësimit, trajnimit për avokim dhe krijim të rrjetëzimit, ne bëjmë çdo përpjekje të fuqizojmë gratë t'i arrijnë ëndërrat e tyre dhe t'i tejkalojnë pengesat për avokim në politika, të kandidohen, të qeversin dhe të jenë pjesë e marrjes së vendimeve në jetën politike të vendit" tha ai.

Ambasadorja Tracey Ann Jacobson, Ambasadore e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, në fjalimin e saj tha se SHBA, është e përkushtuar për mundësi të barabarta për meshkuj dhe femra. Ne në Kosovë kemi punuar ngushtë me Grupin e Grave Deputete, grupimi më i mirë nder-partiakë në Parlament.
Zonja Jacobson, theksoj një ndër ngjarjet më me rëndësi gjatë qëndrimit të saj në Kosovës, Samitin Ndërkombëtar të Gruas dhe Parimet e Prishtinës si rezultat i samitit dhe formimin e Odës Ekonomike të Gruas.

Jacobosn, perfundoj fjalimin duke shpresuar që në zgjedhjet lokale të këtij viti të ketë femra të zgjedhrua Kryetare të Komunave. Aktualisht në Kosovë, të gjithë kryetarët e Komunave janë meshkuj.

Në fjalimin e saj përshëndetës, Shkëlqesia e saj Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, falenderoj punën e NDI që në bashkëpunim me Grupin e Grave Deputete janë duke fuqizuar pozitën e gruas në Kosovë. "Fuqizimi i gruas nuk është vetëm fuqizim personal, por i tërë vendit" theksoj ajo.
Presidentja poashtu përmendi edhe Samitin e Gruas të mbajtur ne tetor të vitit të kaluar ku u hartuan Parimet e Prishtinës dhe u miratua rezuluta në Kuvendin e Kosovës, ku një ndër parimet e miratuara është edhe realizimi i 50% të grave përfaqësim në shërbimin civil deri ne vitin 2050. Presidentja, poashtu përmendi se në Kosovë ka vetëm një nënkyretare në nivelin lokal, dhe asnjë kryetare të komunës.

Pjesa e dytë vazhdoj me diskutim në panel, pasqyrimi i javës, me:

- Susan Markham, Drejtoreshë e NDI për programin e pjesëmarrjes politike të grave
- Judy Wasylycia-Leis, Ish deputete e Dhomës Përfaqësuese në Kanadë
- Nate Evans, Këshilltar i NDI
- Pamela Hart, Drejtore Ekzekutive e kompanisë "Liroje zërin tuaj"

###

Çka është Java e Gruas 2013?
Java e Gruas do të mbledhë gratë lidere të së ardhmes nga të gjitha segmentet e shoqërisë për të marrë pjesë në një javë diskutimi ku ato do të mund të diskutojnë, mësojnë dhe forcojnë shkathtësitë dhe teknikat për tu bërë 445më efektive në fushën e tyre.

Kush do të marrë pjesë në këtë ngjarje?
Në këtë ngjarje do të marrin pjesë njëqind (100) gra të cilat përfaqësojnë partitë politike, kuvendin, qeverinë, qeverisjen lokale, mediat, universitetet, shoqërinë civile dhe biznesin. Java e Gruas në Kosovë

do të reflektojë po ashtu pjesëmarrjen e barabartë nga të gjitha regjionet e Kosovës si për nga etnia ashtu edhe nga mosha.

Ku dhe kur do të mbahet Java e Gruas 2013?
Java e Gruas 2013 do të filloj me **25 Mars** dhe do të përfundoj me **29 Mars,** si dhe do të mbahet në Prishtinë në Hotelin Emerald. Për më shumë detaje ju lutem konsultoni agjendën dhe faqen tonë të internetit në www.weekofwomen.org

###

Për më shumë informata, ju lutem konsultoni faqen tonë të internetit www.weekofwomen.org , apo faqen tonë në facebook http://www.facebook.com/pages/Week-of-Women/192559664187104, ose kontaktoni Arta Qorri përmes emailit: aqorri@ndi.org, apo telefonit: +377 44 170 703.

Insituti Kombëtar Demokratik (NDI) *është organizatë jo profitabile që punon për të fuqizuar dhe zgjeruar demokracinë në mbarë botën. Duke u thirrur në rrjetin global të ekspertëve vullnetarë, NDI ofron ndihmë praktike për liderët e shoqërisë civile dhe partive politike duke i avancuar vlerat demokratike, praktikat dhe institucionet. NDI punon me demokratët në çdo rajon të botës për të ndërtuar organizatat politike dhe të shoqërisë civile, zgjedhje të sigurta duke promovuar pjesëmarrjen qytetare, transparencën, dhe përgjegjshmërinë nga Qeveria. Asistenca financiare dhe teknike per NDI për ngjarjen e Javës së Gruas është pjesë e një programi të gjerë të financuar nga USAID për nxitjen e qeverisjes efektive në nivelin lokal dhe qëndror nga partitë politike, të zhvillojë lidershipin e partive politike nga rradhët e komuniteteve, të rrisë besimin e qytetarëve në procesin e zgjedhjeve dhe e tërë kjo mundësohet nga mbështetja bujare e popullit Amerikan. Për më shumë informata për NDI, ju lutem konsultoni faqen tonë në internet:* ***www.ndi.org***